REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA E TATIMPAGUESVE TË MËDHENJ
DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TATIMPAGUESEVE
Sektori i Regjistrimit

Nr. 25 Prot. Tiranë, më 18.02 2019

Lënda: **Konfirmim Bilanci**

SUBJEKTI: KEVIN CONSTRUKSION,
NIPTI: K71401004W
Adresa: Rruga Adem Jashari, Ndertesa 4, Hyrja 10, Njesia Bashkiake Nr.5

TIRANË

Në përgjigje të kërkesës suaj me nr 24, prot.datë 15.12.2018 dorëzuar pranë Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj me objekt "Kërkesë për konfirmim të pasqyrave financiare", ju dërgojmë bashkëlidhur kopje të konfirmuar të pasqyrave financiare për subjektin "KEVIN CONSTRUKSION" me Nipt- K71401004W për vitin 2018 deklaruar online nga ana juaj në sistemin tatimor c@ts në datën 14.02.2019.

Drejtor i Drejtorisë se Sherbimit te Tatimpaguesve

ELONA SHUPERKA

NË MUNGESË DHE ME URDHË
PËRGJEGJËS I SEKTORIT TË ASISTENCËS DHE SHËRBIMIT

Laureta Sako

Adresa: **Rr: Nikolla Lena, Tiranë, Shqipëri**
Tel: ++355 42 425901/902

Web site: www.tatime.gov.al

R A P O R T

I AUDITUESIT LIGJOR
PER AUDITIMIN E BILANCIT TE VITIT 2018

(SHOQERIA TREGETARE "KEVIN CONSTRUKSION" SH.P.K)
NIPT K71401004W

AUDITUESI LIGJOR

BUJAR OSMANI
NIPT K31510105L

07.02.2019

I.E.K.A.
Bujar Osmani
EKSPERT KONTABEL
Tiranë Shqipëri

BUJAR OSMANI
AUDITUES LIGJOR telefon: 0355692055968

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

PER ORTAKUN E VETEM TE SHOQERISE "KEVIN CONSTRUKSION " sh.p.k TIRANE .

OPINIONI

Une kam audituar pasqyrat financiare te shoqerise "KEVIN CONSTRUKSION" sh.p.k, te cilat perfshijne pasqyren e pozicionit financiar me daten 31 dhjetor 2018, pasqyren e te ardhurave gjithpershirese,pasqyren e ndryshimeve ne kapital dhe pasqyren e flukseve te parase qe mbyllet ne kete date, si edhe shenimet per pasqyrat financiare , perfshire nje permbledhje te politikave kontabel me te rendesishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit(SKK-të) në Shqipëri.

BAZA PER OPINIONIN

Ne e kryem auditimin tone ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Auditimit. Pergjegjesite tona sipas ketyre standardeve jane pershkruar ne menyre te detajuar ne seksionin e raportit ku jepen Pergjegjesite e Audituesit per Pasqyrat Financiare. Ne jemi te pavarur nga Shoqeria ne perputhje me kerkesat etike qe jane te zbatueshme per auditimin e pasqyrave financiare ne Shqiperi, dhe kemi permbushur pergjegjesite e tjera etike ne perputhje me keto kerkesa. Ne besojme se evidenca e auditimit qe kemi siguruar eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene nje baze per opinionin tone.

Informacione të tjera të ndryshme nga Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë çdo informacion financiar ose jo financiar që jepet në raportin vjetor që mund të publikohet si një document i vetëm, ose një kombinim i dokumenteve, por që ndryshojnë nga pasqyrat financiare të audituara dhe raporti i audituesit mbi këto pasqyra.
Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.
Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale. Nëse, bazuar në punën e kryer, ne arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.
Ne, nga informacionet që kemi siguruar para datës së raportit të audituesit, nuk kemi asgjë për të raportuar.

PERGJEGJESIA E DREJTIMIT DHE PERSONAVE TE NGARKUAR ME QEVERISJEN NE LIDHJE ME PASQYRAT FINANCIARE.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit(SKK-të), dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.
Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.
Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

PERGJEGJESITE E AUDITUESIT PER AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE.

Objektivat tona jane qe te arrijme nje siguri te aresyeshme lidhur me faktin nese pasqyrat financiare ne teresi nuk kane anomali materiale , per shkak te mashtrimit apo gabimit, dhe te leshojme nje raport auditimi qe perfshin opinionin tone. Siguria e aresyeshme eshte nje siguri e nivelit te larte, por nuk eshte nje garanci qe nje auditim i kryer sipas SNAV-ve do te identifikoje nje anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalite mund te vijne si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nese, individualisht ose te mara se bashku, pritet qe ne menyre te aresyeshme te influencojne vendimet ekonomike te perdoruesve , te marra bazuar ne keto pasqyra financiare.

Një përshkrim më i detajuar i përgjegjësive të audituesit për auditimin e pasqyrave financiare mund të gjendet në shtojcën bashkangjitur raportit. Ky përshkrim përbën pjesë të raportit tonë të auditimit.

AUDITUES LIGJOR

Bujar OSMANI

Me 07.02.2019

Shtojcë e raportit të audituesit

Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.
- Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë ose që ekziston një anomali materiale në informacionet e tjera, ku çdonjëra prej tyre mund të dëmtojë besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe të raportit të audituesit mbi këto pasqyra. Këto anomali materiale mund të influencojnë në mënyrë të papërshtatshme vendimet e përdoruesve për të cilët është përgatitur raporti i audituesit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE - DREJTORIA E SHËRBIMIT PËR TATIMPAGUESIT - MFE - DREJTORIA E TATIMPAGUESVE TË MËDHENJ

I.E.K.A. Bujar Osmani EKSPERT KONTABEL

Emertimi dhe Forma ligjore	"KEVIN CONSTRUKSION" SH.P.K
NIPT -i	K71401004W
Adresa e Selise	Rruga "Adem Jashari" , Ndertesa 4 ,Hyrja 10
	Njesia Bashkiake Nr. 5 ,Tirane
Data e krijimit	Dt. 13,12,2006
Nr. i Regjistrit Tregetar	Nr. 36731
Veprimtaria Kryesore	Veprimatri ne fushen e Ndertimit privat dhe publik , ndertime civile , industriale , turistike dhe Rikonstruksion

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr.2 te Permiresuar dhe Ligjit Nr. 9228 Date 29.04.2004 Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare)

Viti 2018

REPUBLIKA E SHQIPERISE · NDERTIM · IMPORT · EXPORT · KEVIN CONSTRUKSION · NIPT: K71401004W

Pasqyra Financiare jane individuale	
Pasqyra Financiare jane te konsoliduara	
Pasqyra Financiare jane te shprehura ne	Leke
Pasqyra Financiare jane te rumbullakosura ne	0,00 Leke

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare	Nga	01.01.2018
	Deri	31.12.2018
Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare		28/01/2019

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci)

Nr	A K T I V E T	VITI 2018	VITI 2017
	Aktivet Afatshkurtra		
	▶ **Aktivet monetare**	**136,417,203**	**129,876,436**
	1 *Banka*	135,513,838	129,205,692
	2 *Arka*	903,365	670,744
	▶ **Investime**		
	1 *Në tituj pronësie të njësive ekonomike brenda grupit*		
	2 *Aksionet e veta*		
	3 *Te tjera Financiare*		
	▶ **Të drejta të arkëtueshme**	**264,958,936**	**219,187,703**
	1 *Nga aktiviteti i shfrytëzimit*	240,741,641	219,164,550
	2 *Nga njësitë ekonomike brenda grupit*		
	3 *Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*		
	4 *Të tjera*	24,217,295	23,153
	5 *Kapital i nënshkruar i papaguar*		
	▶ **Inventarët**	**1,959,768**	**5,990,929**
	1 *Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme*	245,903	588,902
	2 *Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte*		
	3 *Produkte të gatshme*		
	4 *Mallra*		
	5 *Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)*		
	6 *AAGJM të mbajtura për shitje*		
	7 *Parapagime për inventar*	1,713,865	5,402,026
	▶ **Shpenzime të shtyra**		
	▶ **Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara**		
I	**TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA**	**403,335,907**	**355,055,067**
	Aktivet Afatgjata		
	▶ **Aktive financiare**		
	1 *Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit*		
	2 *Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit*		
	3 *Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*		
	4 *Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*		
	5 *Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata*		
	6 *Tituj të tjerë të huadhënies*		
	▶ **Aktivet materiale**	**50,572,938**	**57,320,126**
	1 *Toka dhe ndërtesa*	23,431,000	24,380,000
	2 *Impiante dhe makineri*	18,396,086	23,748,241
	3 *Të tjera Instalime dhe pajisje*	8,745,852	9,191,885
	4 *Parapagime për aktive materiale dhe në proces*		
	▶ **Ativet biologjike**		
	▶ **Aktive jo materiale:**		
	1 Koncesione,patenta,liçenca,marka tregtare,të drejta dhe aktive të ngjashme		
	2 *Emri i Mirë*		
	3 *Parapagime për AAJM*		
	▶ **Aktive tatimore të shtyra**		
	▶ **Kapitali i nënshkruar i papaguar**		
II	**TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA**	**50,572,938**	**57,320,126**
	AKTIVE TOTALE	**453,908,845**	**412,375,193**

ADMINISTRATOR
LAVDRIM GJICI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NDERTIM-IMPORT/EXPORT
KEVIN
CONSTRUCTION
NIPT: K71401004W / TIRANE

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci)

Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	Viti 2018	Viti 2017
	▶ **Detyrime afatshkurtra:**	**287,202,469**	**272,845,688**
	1 *Titujt e huamarrjes*		
	2 *Detyrime ndaj institucioneve të kredisë*	86,241,868	27,598,681
	3 *Arkëtime në avancë për porosi*		
	4 *Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit*	196,351,200	242,936,923
	5 *Dëftesa të pagueshme*		
	6 *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit*		
	7 *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*		
	8 *Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore*	3,221,890	1,480,097
	9 *Të pagueshme për detyrimet tatimore*	1,387,510	829,987
	▶ **Të pagueshme për shpenzime të konstatuara**		
	▶ **Të ardhura të shtyra**		
	▶ **Provizione**		
	Totali i Detyrimeve afatshkurtera	**287,202,469**	**272,845,688**
	▶ **Detyrime afatgjata:**	**6,995,327**	**7,220,128**
	1 *Titujt e huamarrjes*		
	2 *Detyrime ndaj institucioneve të kredisë*		
	3 *Arkëtimet në avancë për porosi*	5,833,332	7,220,128
	4 *Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit*		
	5 *Dëftesa të pagueshme*		
	6 *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit*		
	7 *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*		
	8 *Të tjera të pagueshme*	1,161,995	
	▶ **Të pagueshme për shpenzime të konstatuara**		
	▶ **Të ardhura të shtyra**		
	▶ **Provizione:**		
	1 *Provizione për pensionet*		
	2 *Provizione të tjera*		
	▶ **Detyrime tatimore të shtyra**		
	Totali i Detyrimeve afatgjata	**6,995,327**	**7,220,128**
	DETYRIMET TOTALE	**294,197,796**	**280,065,816**
	▶ **Kapitali dhe Rezervat**		
	▶ **Kapitali i Nënshkruar**	88,692,102	73,488,000
	▶ **Primi i lidhur me kapitalin**		
	▶ **Rezerva rivlerësimi**		
	▶ **Rezerva të tjera**		
	1 *Rezerva ligjore*	2,109,883	1,309,667
	2 *Rezerva statutore*		
	3 *Rezerva të tjera*	41,507,392	41,507,392
	▶ **Fitimi i pashpërndarë**		
	▶ **Fitim / Humbja e Vitit**	27,401,672	16,004,318
	Totali i Kapitalit	**159,711,049**	**132,309,377**
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	**453,908,845**	**412,375,193**

ADMINISTRATOR
LAVDRIM GJICI

Pasqyra e Performancës
(Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)
Formati 1 – Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës

Nr.	Pershkrimi i Elementeve	VITI 2018	VITI 2017
▶	**Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**	**230,248,936**	**248,365,420**
▶	**Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces**		
▶	**Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar**		
▶	**Të ardhura të tjera të shfrytëzimit**		
▶	**Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme**	**(139,409,207)**	**(130,002,470)**
	1 *Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme*	(139,409,207)	(130,002,470)
	2 *Të tjera shpenzime*		
▶	**Shpenzime të personelit**	**(16,036,008)**	**(19,263,423)**
	1 *Paga dhe shpërblime*	(13,918,582)	(16,670,619)
	2 *Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)*	(2,117,426)	(2,592,804)
▶	**Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale**		
▶	**Shpenzime konsumi dhe amortizimi**	**(6,747,015)**	**(6,887,056)**
▶	**Shpenzime të tjera shfrytëzimi**	**(47,889,743)**	**(88,314,462)**
▶	**Të ardhura të tjera**	**12,070,297**	**15,809,545**
	1 *Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)*		
	2 *Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)*	947,297	
	3 *Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)*	11,123,000	15,809,545
▶	**Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra**		
▶	**Shpenzime financiare**	-	**(103,200)**
	1 *Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)*		
	2 *Shpenzime të tjera financiare*		(103,200)
▶	**Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet**		
▶	**Fitimi/Humbja para tatimit**	**32,237,261**	**19,604,355**
▶	**Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**	**(4,835,589)**	**(3,600,037)**
	1 *Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin*	(4,835,589)	(3,600,037)
	2 *Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë*		
	3 *Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve*		
▶	**Fitimi/Humbja e vitit**	**27,401,672**	**16,004,318**
▶	**Fitimi/Humbja për:**	-	-
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë		
	Interesat jo-kontrolluese		

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

Nr	Pershkrimi i Elementeve	2018	2017
▶	Fitimi/Humbja e vitit	27,401,672	16,004,318
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-
	Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja	-	-
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	-	-
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktivet financiare të mbajtura për shitje	-	-
	Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet	-	-
▶	Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-
▶	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	27,401,672	16,004,318
▶	Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:	27,401,672	16,004,318
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë		
	Interesat jo-kontrolluese		

ADMINISTRATOR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NDËRTIM · IMPORT · EKSPORT
KEVIN

Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare
(metoda indirekte)

		VITI 2018	VITI 2017
►	**Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit**		
	Fitim / Humbja e vitit	32,237,261	19,604,355
	Rregullimet për shpenzimet jomonetare:	(947,292)	103,200
	Shpenzimet financiare jomonetare		
	Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	(4,835,589)	(3,600,037)
	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	(6,747,015)	(6,887,056)
	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
	Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
	Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
	Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
	Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(45,771,233)	(35,148,263)
	Rënie/(rritje) në inventarë	4,031,161	370,034
	Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(47,414,995)	3,752,427
	Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	1,741,793	(2,378,877)
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	**(67,705,910)**	**(24,184,217)**
►	**Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit**		
	Para neto të përdorura për blerjen e filialeve		
	Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve		
	Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	13,494,203	9,510,112
	Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
	Pagesa për blerjen e investimeve të tjera		
	Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera		
	Dividentë të arkëtuar		
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	**13,494,203**	**9,510,112**
►	**Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit**		
	Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		
	Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral		
	Hua të arkëtuara	59,805,182	4,498,681
	Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë		
	Riblerje e aksioneve të veta		
	Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral		
	Pagesa e huave		
	Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare		
	Interes i paguar		
	Dividendë të paguar		(33,400,000)
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	**59,805,182**	**(28,901,319)**
	Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	**5,593,475**	**(43,575,424)**
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	**129,876,436**	**173,555,060**
	Efekti i luhatjeve te kursit të këmbimit të mjeteve monetare	**947,292**	**(103,200)**
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	**136,417,203**	**129,876,436**

ADMINISTRATOR
LAVDRIM GUCI

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
▶ **Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015**	73,488,000			715097	0	40,030,513.50	0	11,891,412	0	0	126,125,023
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabel											
▶ **Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2XX1**											
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:											
Fitimi / Humbja e vitit								23,580,036			
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:				594,570		11,296,842.23		(11,891,412)			
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:											
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:											
Emetimi i kapitalit të nënshkruar											
Dividendë të paguar											
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike											
▶ **Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2016**	73,488,000	-	-	1,309,667	-	51,327,356	-	23,580,036	-	-	149,705,059
▶ **Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2XX2**											
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:											
Fitimi / Humbja e vitit								16,004,318			
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:						23,580,036.06		(23,580,036)			
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:											
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:											
Emetimi i kapitalit të nënshkruar											
Dividendë të paguar						(33,400,000)					
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike											
▶ **Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017**	73,488,000	-	-	1,309,667	-	41,507,391.79	-	16,004,318	-	-	132,309,377
▶ **Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2XX2**											
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:											
Fitimi / Humbja e vitit								27,401,672			
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:	15,204,102			800,216				(16,004,318)			
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:											
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:											
Emetimi i kapitalit të nënshkruar											
Dividendë të paguar											
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike											
▶ **Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018**	88,692,102	-	-	2,109,883	-	41,507,392	-	27,401,672	-	-	159,71[illegible]

ADMINISTRATOR
LAVDRIM GJICI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NDERTIM-IMPORT-EXPORT
KEVIN CONSTRUCTION

"Kevin Construksion " shpk
NIPT : K71401004W

Aktivet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2018

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 1/1/2018	Shtesa	Pakesime	Gjendje 12/31/2018
1	Toka		9,400,000			9,400,000
2	Ndertime		14,980,000			14,980,000
3	Makineri,paisje		14,924,985			14,924,985
4	Mjete transporti		25,271,843			25,271,843
5	Pajisje kompjuterike		788,648			788,648
1	Te tjera		4,508,412			4,508,412
2	Pajisje zyre		19,906,880			19,906,880
3	Te tjera		4,000,000			4,000,000
	TOTALI		*93,780,768*	-	-	*93,780,768*

Amortizimi A.A.Materiale 2018

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 1/1/2018	Shtesa	Pakesime	Gjendje 12/31/2018
1	Toka		-	-		-
2	Ndertime		-	949,000		949,000
3	Makineri,paisje		13,799,803	2,806,577		16,606,393
4	Mjete transporti		14,308,675	2,495,630		16,804,305
5	Pajisje kompjuterike		3,377,550			3,377,550
6	Te tjera		2,221,278	495,808		2,717,086
7	Pajisje zyre		2,753,510			2,753,497
						-
						-
	TOTALI		*36,460,816*	*6,747,015*	-	*43,207,831*

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2018

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 12/31/2017	Shtesa	Pakesime	Gjendje 12/31/2018
1	Toka		9,400,000			9,400,000
2	Ndertime		14,980,000		749,000	14,231,000
3	Makineri,paisje		7,417,329			7,417,329
4	Mjete transporti		12,483,149		2,495,630	9,987,519
5	Pajisje kompjuterike		355,188			355,188
6	Te tjera		2,098,653		495,808	1,602,845
7	Pajisje zyre		6,585,807		2,806,577	3,779,230
8	Te tjera		4,000,000		200,000	3,800,000
	TOTALI		*57,320,126*	-	*6,747,015*	*50,572,938*

Administratori
Lavdrim

Rr."Adem Jashari", Nd. 4, H. 10, Njesia Bashkiake Nr. 5, Tirane
Tel.04 2267 883, Fax.04 2248 470 www.kevinconstruksion.net • E-mail: info@kevinconstruksion.net

Gjendje E Mjeteve të Transportit dt.31.12.2018

NR	PERSHKRIMI	NJESIA	TARGA	VLERE /LEKE
1	Autokarro bujqesore	COPE	TR 3196 R	193,178
2	Kamion Mercedez Benc	COPE	TR 7972 S	1,101,570
3	Daimbler Benz	COPE	TR 0482 T	3,000,000
4	Kamion benz CAT	COPE	AA159HX	765,000
5	Ekskavator Caterpilar Tip 320	COPE		3,500,000
6	Fadrome	COPE	AA268DI	2,929,500
7	Minieskavator Kubota	COPE		1,400,000
8	Mercedens Benz	COPE	TR 100 KE	11,482,595
TOTALI				24,371,843

ADMINISTRATOR

LAVDRIM GJICI

KEVIN CONSTRUKSION SHPK

Pasqyrat Financiare Individuale per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018

KEVIN Construksion Sh.p.k.
Pasqyra individuale e pozicionit financiar
me 31 dhjetor 2018
(ne leke)

1. Informacion i pergjithshem

KEVIN Construksion sh.p.k. (referuar si "Shoqeria") eshte regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e regjistruar ne Regjistrin Tregetar me Nr. 36731 me daten 13,12,2016 dhe me Degen e Tatimeve dhe Taksave Tirane me NIPT K71401004W.

Ne perputhje me statutin dhe aktin e themelimit, aktiviteti i Shoqerise konsiston ne fushen e sipermarjes se ndertimit me fonde publike etj.
Shoqeria zoterohet nga nje ortak , Z.LAVDRIM GJICI , ortak I vetem ne masen 100% te kapitalit .
Vlera e kapitalit : 88,692,102 leke.

Me 31 dhjetor 2018 perfaqesuesi ligjor i Shoqerise eshte z. Lavdrim Gjici . Numri i punonjesve te Shoqerise me 31 dhjetor 2018 eshte 177 te punesuar . Adresa e Shoqerise eshte : Rruga Adem Jashari ,Ndertesa 4 , Hyrja 10,Njesia Bashkiake Nr. 5,Tirane.

2. Bazat e pergatitjes se pasqyrave

2.1 Perputhshmeria

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te shpallura me date 15 qershor 2006 ne perputhje me Ligjin 9228, date 29 prill 2004 te ndryshuar me ligjin 9477, date 9 shkurt 2006.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

2.3 Periudhat krahasimore

Te dhenat e periudhave te meparshme te vitit 2017 shoqeria I krahason me te dhenat e vitit ushtrimor 2018.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Lek, e cila eshte dhe monedha funksionale e Shoqerise.

2.5 Vleresime dhe gjykime

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te shoqerise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje ne varesi te ketyre vleresimeve.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel jane te njohura ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar si dhe ne periudhat e ardhshme qe preken.

Ne veçanti, informacionet mbi fushat me te rendesishme te vleresimeve dhe gjykimeve ne aplikimin e politikave kontabel te cilat kane efektet me te rendesishme ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare, jane pershkruar ne shenimet perkatese te pasqyrave financiare.

3. Politikat kontabel

Politikat kontabel te meposhtme jane aplikuar ne menyre konsistente nga Shoqeria, perveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Investime ne shoqerite e kontrolluara

Investimet ne shoqerite e kontrolluara kontabilizohen mbi bazen e metodes se kostos. Ato njihen fillimisht me kosto, dhe me pas zhvleresohen per te reflektuar vleren e realizueshme te investimit. Humbja nga zhvleresimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Kosto e investimit perfshin te gjitha kostot e transaksionit

3.2 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e raportimit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jomonetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlera e drejte.

Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.
Kurset e kembimit te perdorura ne konvertimin e aseteve dhe detyrimeve monetare ne monedhe te huaj Jane:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Euro/Lek	123.90	132.95

3.3 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare joderivative perbehen nga kerkesa per t'u arketuar, mjete monetare, hua te marra dhe te dhena, dhe detyrime per t'u paguar.

Instrumentat financiare joderivative njihen fillimisht me vleren e drejte plus çdo kosto transaksioni qe lidhet me to, perveç siç pershkruhet me poshte. Per instrumentat e mbajtur me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, kostot e transaksionit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Ne vijim te njohjes fillestare instrumentat financiare joderivative maten siç pershkruhet me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te shoqerise mbi flukset e parase se aktivit financiar ose kur shoqeria transferon aktivin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithe risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen shoqeria angazhohet te bleje apo te shese aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anullohen.

Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat. Per qellimin e pasqyres se flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet te saj perfshijne depozita pa afat me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

Kerkesa per t'u arketuar

Kerkesat per t'u arketuar njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provigjoni per zhvleresimin e kerkesave per t'u arketuar llogaritet kur ka te dhena se shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia

qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar dhe mospagesa apo pagesa e vonuar konsiderohen tregues qe kerkesat per t'u arketuar te zhvlereschen. Shuma e provigjonit llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Detyrime per t'u paguar

Detyrimet per t'u paguar paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Hua te marra dhe te dhena

Huate e marra dhe te dhena njihen fillimisht me vleren e tregut, pa perfshire koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huate e marra dhe te dhena paraqiten me kosto te amortizuar duke njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve çdo diference midis kostos dhe vleres se pagueshme nominale pergjate periudhes se huamarrjes duke u bazuar ne interesin efektiv.

Vlera e drejte

Vlerat e drejta te perllogaritura te mjeteve monetare dhe ekuivalenteve te tyre, te kerkesave per t'u arketuar, detyrimeve per t'u paguar dhe huave perafrohen me vlerat e tyre kontabel.

Te tjera

Instrumenta te tjere joderivative maten me kosto te amortizuar sipas metodes se interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvleresimi.

3.4 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar.
Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve te vete-ndertuara perfshin koston e materialeve dhe punes direkte, çdo kosto tjeter te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivit ne gjendje pune per qellimin e synuar te perdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes ne gjendjen e meparshme te vendndodhjes se aktivit. Shpenzimet kapitale te bera gjate ndertimit kapitalizohen ne "Ndertim ne proces" dhe transferohen ne kategorine perkatese te aktivit kur perfundon ndertimi tij, nga kur aplikohet amortizimi perkates sipas kategorise.
Ne rastet kur pjese te nje aktivi afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur, dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave.

(ii) Kostot e mepasshme

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundur qe shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jeten e vleresuar te çdo pjese te aktivit afatgjate material duke filluar nga data e venies ne pune. Aktivet e marra me qira amortizohen duke perdorur metoden lineare te amortizimit mbi jeten e vleresuar te çdo pjese te aktivit afatgjate material dhe duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivit. Toka nuk amortizohet.

Metodat dhe perqindjet e amortizimit per secilen kategori aktivesh afatgjata per periudhen aktuale jane si me poshte:

Ndertesa	Mbi vleren kontabel neto	5%
Mjete transporti	Mbi vleren kontabel neto	20%
Mobilje dhe orendi	Mbi vleren kontabel neto	20%
Pajisje informatike	Mbi vleren kontabel neto	25%
Te tjera active	Mbi vleren kontabel neto	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne çdo date raportimi.

3.5 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale qe kane nje jete te percaktuar maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvleresimi. Amortizimi llogaritet mbi koston e blerjes se aktivit. Shuma e amortizimit kalon ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne menyre zbritese pergjate jetes se aktivit.

3.6 Zhvleresimi

(i) Aktivet financiare

Nje aktiv financiar konsiderohet i zhvleresuar nese ka te dhena objektive qe tregojne se nje apo disa ngjarje kane efekte negative ne flukset e ardhshme qe parashikohet te burojne nga aktivi.

Nje zhvleresim ne lidhje me aktivin financiar, te matur me kosto te amortizuar, llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktivet financiare te rendesishme individualisht testohen per zhvleresim ne menyre individuale. Aktivet e tjera financiare vleresohen ne menyre te grupuar, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te rrezikut.

Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me nje aktiv financiar i disponueshem per shitje i njohur me pare ne kapital, njihet ne shpenzime.

Nje humbje nga zhvleresimi rimerret nese rimarrja mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pas njohjes se humbjes nga zhvleresimi. Per aktivet financiare te matura me kosto te amortizuar, rimarrja njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) *Aktivet jofinanciare*

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare te shoqerise, rishikohet ne çdo date raportimi per te percaktuar nese ka te dhena per zhvleresim. Nese ka te dhena te tilla atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Nje humbje nga zhvleresimi njihet nese vlera e mbetur e nje aktivi tejkalon vleren e tij te rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

3.7 Inventari

Inventaret percaktohen me vleren me te vogel midis kostos dhe vleres neto te realizueshme. Kostoja percaktohet duke perdorur metoden e mesatares se ponderuar dhe perfshin shpenzimet e kryera per perfitimin e inventarit dhe kosto te tjera te kryera per dergimin e inventareve ne destinacion dhe me kushtet e kerkuara. Vlera e realizueshme neto eshte çmimi i llogaritur i shitjes ne aktivitetin normal te biznesit, duke zbritur shpenzimet variabel te shitjes.

3.8 Provigjonet

Nje provigjon njihet nese, si rezultat i nje ngjarje te shkuar, shoqeria ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe do te kerkoje flukse dalese parash per shlyerjen e tij.

Provigjonet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te parase me nje norme skontimi

para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per rreziqet qe lidhen me detyrimin ne fjale.

3.9 Njohja e te ardhurave

Shitja e mallrave

Te ardhurat nga shitja e mallrave gjate rrjedhes normale te biznesit maten me vleren e drejte, duke zbritur kthimet e mundshme te mallrave, zbritjet tregetare dhe rabatet. Te ardhurat njihen atehere kur rreziqet dhe perfitimet e rendesishme jane transferuar tek bleresi, marrja e sherbimit eshte e sigurt, kostot perkatese si dhe kthimet e mundshme te mallrave mund te vleresohen ne menyre te besueshme, nuk ka perfshirje te shitesit ne menaxhimin e mallrave, si dhe shuma e te ardhurave mund te matet me besueshmeri.

Shitja e sherbimeve

Te ardhurat nga sherbimet e ofruara njihen ne pasqyren e te ardhurave ne varesi te fazes se perfundimit te transaksionit ne daten e bilancit. Asnje e ardhur nuk njihet nese ka pasiguri te larte lidhur me kryerjen e pageses dhe kostove perkatese.

3.10 Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite bankare dhe fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Te ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara duke perdorur metoden e interesit efektiv.
Shpenzimet financiare perfshijne shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e interesit efektiv.

3.11 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin tatimin e periudhes, i cili njihet drejtperdrejt ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhes eshte tatimi i pritshem per t'u paguar mbi te ardhurat e tatueshme te vitit, duke perdorur normat tatimore te miratuara ne periudhen e raportimit.

4 Mjete monetare

Mjetet monetare me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 perbehen si me poshte:

	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2017
Llogari rrjedhese:		
Lek	135,513,838	129,205,692
Euro		
	135,513,838	**129,205,692**
Arka:		
Lek	903,365	670,744
Euro		
	903,365	**670,744**
TOTALI	**136,417,203**	**129,876,436**

5 . **Te drejta te arketueshme**

Kerkesat per t'u arketuar me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 perbehen si me poshte:

	Viti I mbyllyr me 31 dhjetor 2018	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2017
Nga aktiviteti I shoqerise	240,741,641	219,164,550 -
TOTALI	**240,741,641**	**219,164,550-**

Te arketueshme te tjere detajohen me tej si me poshte:

	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2017
Te tjera	24,217,295	23,153-
TOTALI	**24,217,295**	**23,153-**

Shuma **24,217,295** leke per Vitin 2018 perbehet nga shuma 22,200,000 leke e cila tregon te drejtat dhe detyrimet e arketueshme nga ortaku dhe shuma 2,017,295 leke tregon gjendjen debitore te TVSH -se.

6. **Inventaret**

Inventari i Shoqerise me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 perbehet si me poshte:

	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2017
Materiale Ndihmese	245,903	588,902
Parapagime per inventar	1,713,865	5,402,026
TOTALI	**1,959,768**	**5,990,929**

Lenda e pare **245,903** leke perbehet nga gjendja e materialeve te para ne fund te vitit te vleresuara me mesataren e ponderuar .
Parapagesat per furnizime **1,713,865** leke pasqyron pagesat ne avance per blerje pajisje dhe materiale : Klimateknika TB2 sh.p.k per vleren , 250,000 leke ,Pespa Alumin sh.p.k ne vlere 102,561 leke ,Agron LLuka ne vleren 335,848 leke si dhe pages ate tjera ne avance ne vleren 1,025,456 leke.

7.Detyrime afatshkurtra

Detyrimet per t'u paguar dhe parapagimet me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 perbehen si me poshte:

	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2017
Arketime ne avance per porosi	5,833,332	7,220,128
Detyrime ndaj instituc te kredise (overdraft)	86,241,868	27,598,681
Furnitore	196,351,200	242,963,923
Te tjera te pagueshme	1,161,995	0
Te pagueshme ndaj punonjesve	3,221,890	1,480,097
Te pagueshme per detyrime tatimore	1,387,510	829,987
TOTALI	**294,197,796**	**280,065,816**

8.Te ardhura nga shitja e mallrave

Te ardhurat nga shitja e sherbimeve gjate vitit te mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 jane si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Te ardhura nga shitja e sherbimeve	230,248,936	248,365,420
TOTALI	**230,248,936**	**248,365,420**

Shuma **230,248,936** leke e te ardhurave e deklaruar ne PASH nuk perputhet me shumen **228,862,141** leke te deklarimeve te FDP ne sistemin tatimor ne vlere **1,386,795 leke**. Kjo mosperputhje sqarohet si meposhte :
Nga viti 2017 eshte mbartur nje mosrakordim ne shumen7,220,128 leke, e cila ka lidhje me faturen nr. 23476285 dt 11.08.2017 e deklaruar si fature shitje paradhenie në vitin 2017, por qe eshte pasqyruar si punime te realizuara dhe te deklaruara me situacion te te ardhurat ne PASH e vitit 2018 sipas fatures nr.23476298 dt 06.02.2018. Nderkohe fatura e shitjesme nr.serial 59619034 dt 11.12.2018, per shumen 5,833,333 leke,eshte deklaruar si paradhenie per arketime ne avance per kryerje te punimeve dhe nuk eshte perfshire ne te ardhurat e vitit 2018 tek PASH, por eshte pasqyruar si kliente kreditore tek pasivi i bilancit. (Diferenca e mosrakordimit eshte**228,862,141** leke +7,220,128 leke-5,833,333 leke= **230,248,936** leke).

8/1.Te ardhura nga interesat ne llogarite bankare

Te ardhurat nga interesat ne llogarite bankare gjate vitit te mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 jane si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Te ardhura nga interesat	11,123,000	15,809,546
TOTALI	**11,123,000**	**15,809,546**

9 Kosto e materialeve te blera

Kostoja e blerjes se lendes se pare dhe materialeve ndihmese te prodhimit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 eshte respektivisht 139,409,207 leke dhe 130,002,470 Leke.

10 Shpenzime te personelit

Kostoja e punes gjate vitit te mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 eshte si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Pagat e personelit	13,918,582	16,670,619
Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetesore	2,117,426	2,592,804
TOTALI	**16,036,008**	**19,263,423**

11 Shpenzime te tjera shfrytezimi

Shpenzimet e tjera per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 perbehen si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Trajtime te pergjithshme	40,056,371	81,803,950

Qira	720,653	1,171,600
Takse bashkie dhe taksa te tjera	0	85,015
Mirmbajtje dhe riparime	83,552	246,411
Te tjera	217,369	111,782
Auditim e sherbim kontabel	430,000	640,000
Sherbime interneti	207,468	217,330
Shpenzime noterizime	357,225	369,916
Shpz. Per kurse punonjesish isso,IQT	128,000	282,780
Shpz. Per ne gjykate	652,775	181,269
Shpz. Per siguracione	307,643	211,529
Shpz. Reklama	0	250,000
Shpz. Postare e telecom	214,600	224,153
Shpz. transporti	189,749	17,667
Shpenzime bankare	179,818	348,188
Shpz. Interesi ovd	3,753,162	0
Taksa e rregjistrimit	276,355	24,417
Taksa per bashkine	115003	165,224
Tatime te tjera	0	1,300
Gjoba dhe demshperblime	0	2,046,946
TOTALI	**47,889,743**	**88,314,462**

12 Shpenzime Financiare

Te ardhurat (shpenzimet) nga kurset e kembimit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 jane si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Fitime te realizuara nga kursi i kembimit	947,297	-
Fitime te parealizuara nga kursi i kembimit	-	-
	947,297	-
Humbje te realizuara nga kursi i kembimit		**(103,200)**
Humbje te parealizuara nga kursi i kembimit		-
	947,297	(103,200)
TOTALI	**947,297**	**(103,200)**

13 Tatim-fitimi

Bazuar ne legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin eshte 15% per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018

Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit por te ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara per qellimetatimi konsiderohen vetedeklarime deri ne momentin qe autoritetet tatimore shqyrtojne deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe leshojne vleresimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare jane objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Rakordimi i rezultatit kontabel me rezultatin fiskal

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Fitimi (humbja) e kontabel e vitit	32,237,261	19,604,355
Rregullime:		
Shpenzimet e panjohura	0	4,395,893
Fitimi (humbja) fiskale e vitit	**27,401,672**	**24,000,248**

Shpenzimet e panjohura jane ne vleren zero .
Shpenzime Tatim Fitimi 4,835,589 leke ka rezultuar pas llogaritjes se fitimit te taksueshem , mbasi kemi zbritur kestet e tatim fitimit te paguara gjate vitit 2018 ne vleren 3,456,178 leke na ngelet nje diference 1,379,410 leke tatim fitim per t'u paguar .

14 Angazhime dhe pasiguri

Gjate aktivitetit te saj te zakonshem, Shoqeria mund te perfshihet ne pretendime apo veprime te ndryshme ligjore nga pale te treta. Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018, Shoqeria nuk ka çeshtje apo pretendime qe do te kene efekt negativ ne pozicionin financiar te Shoqerise ose ndryshime ne aktivet neto te saj. Me 31 dhjetor 2018, Shoqeria nuk ka angazhuar kapitale te kontraktuara por ende te papaguara.

15 Palet e lidhura

Transaksionet dhe gjendjet me ortaket qe jane pale e lidhur me Shoqerine, kane te bejne me hua ndaj Shoqerise apo te drejta te krijuara gjate zhvillimit te aktivitetit te saj (shih shenimet 1, 5 dhe 10)

16. Ngjarje te mepasshme

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.

ADMINISTRATORI

LAVDRIM GJICI